

**Fitotoksiciteti:** Nuk është fitotoksik kur përdoret në kulturat dhe me dozat e rekomanduara. Disa varietete të pemëve frutore farore janë të ndjeshëm ndaj këtij formulimi, prandaj bëj prova paraprake.

**Karenca:** Për vreshtin 14 ditë; domate, specja, kungull 3 ditë; perimet e tjera dhe pemët frutore bërthamore 7 ditë; dardhë 15 ditë; mollë 30 ditë; të lashta trajtimet ndërpriten në fund të lulëzimit.

**Ndikimi në ekosistem:** Helmuës për organizmat ujore. Mos ndotni ujrat dhe burimet ujore që rrjedhin në lumenj e rezervuarë uji.

**Ruajtja dhe magazinimi:** Ruhet në vende të thata, të ajrosura, në ambalazhin origjinal, në temperatura 5 - 35°C.

**FRAZAT PARANDALUESE:** • P261. Evitoni kontaktin e produktit me gojën, lëkurën, sytë dhe thithjen e tretësirës. spërkatëse nëpërmjet frymëmarrjes. • P273 Shmangni shkarkimet dhe derdhjet në mjedis të preparatit. • P280. Gjatë punës përdor paisje mbrojtëse: kominoshe, doreza, maska, syze. • P302+P352. Në rast kontakti me lekuren lahuni me uje të bollshem dhe sapun. Lani pajisjet mbrojtëse pas përfundimit të punës. • P305+P351+P338. Në rast se solucioni bie në sy, shpelajini me kujdes për disa minuta. Hiqni lentet e kontaktit dhe vazhdoni shpëlarjen. • P501. Mblidhni ambalazhet në kontejner dhe beni shkaterimin e tyre sipas rregullave në fuqi.

**FRAZAT E REZIKUT:** • H315. Shkakton iritim të lekures. • H319. Shkakton acarime të renda në sy. • H361. Ka dyshime se demton fertilitetin apo femijen e palindur. • H410 "Shumë toksike për jetën ujore me efekte afatgjata. • EUH401. Zbatoni udhëzimet për përdorimin për të shmangur rreziqet ndaj shëndetit njëzëzor dhe mjedisit

**UDHËZIME PËR NDIHMËN E PARË DHE KËSHILLA PËR MJEKUN:**

- Në rast marrje me organet e frymëmarrjes, nxireni të dëmtuarin në ajër të pastër.
- Kërkoni menjëherë ndihmë mjekësore.
- Në rast se produkti është gëlltimit, mos shkaktoni të vjella. Shpëlani menjëherë gojën. Kërkoni menjëherë ndihmë mjekësore.
- Antidot specifik nuk njihet. Mjekimi sipas simptomave

Data e prodhimit: Printuar në ambalazh  
Afati i ruajtjes: 3 vjet

**1 Lit.**

# ORIOUS 25 EW



**Lënda vepruese:** Tebuconazole 250 g/lit

**Formulimi:** Emulsion ujqor (EW)

**Nr. i regjistrimit:** 510 dt.08/01/2013

## PRODUKT PËR MBROJTJEN E BIMËVE

### FUNGICID SISTEMIK ME VEPRIM PARA- MBROJTËS, KURUES DHE ÇRRËNJOSËS PËR KONTROLLIN E KROMAVE, HIRIT, KALBËZIMEVE DHE SËMUNDJEVE TË TJERA KËPURDHORE NË PEMË FRUTORE, VRESHTARI, PERIME E DRITHRA.



Distributor dhe Ambalazhues:  
MELDI Sh.p.k.  
Tiranë - Shqipëri



Aplikant: ADAMA Agriculture B.V.  
Prodhuesi: ADAMA Makhteshim LTD



**ORIOUS 25 EW** thithet me shpejtësi nga pjesët e gjelbëra të gjetheve duke qarkulluar në drejtim akropetal. Në sajë të depërtimit me shpejtësi në brendësi të lëngjeve bimore, nuk rrezikohet prej shplarjeve nga reshjet.

**Në mollë e dardhë:** Kunder kromës (*Venturia inaequalis*, *V.pirina*) dhe hirit (*Podosphaera leucotricha*). Në trajtimet preventive: duke filluar nga butonat rozë dhe deri kur fruti arrin madhësinë e kokrës së arrës, trajtimet përsëriten cdo 6-8 ditë dhe më pas cdo 10-15 ditë. Në trajtimet kurative trajtimet kryhen jo më vonë se 72-96 orë pas rënies së shiut infektiv) (veprimi retroaktiv). Doza e përdorimit është 40-50 ml/100 lit ujë.

Në mot me reshje rekomandohet përzjerja me Merpan 80 WG, Folpet 80 WDG, Mancozeb 75 WG, për të kombinuar veprimin sistematik me atë të kontaktit. Kunder njollosjes kafe (*Stemphylium vesicarium*), me 50-75 ml/100 lit ujë.

**Në bërthamore** (kajsi, pjeshkë, kumbull, qersh, etj.): kunder monilës (*Monilia spp.*) dhe kalbëzimit gri (*Botrytis spp.*) kryhen 1-2 trajtimet e para gjatë lulëzimit dhe rëzimit të petaleve dhe 1-2 trajtime të tjera kryhen para vjeljes në intervale 7 ditore; kunder hirit (*Sphaerotheca pannosa*) trajtimi i parë kryhet në momentin e rënies së petaleve dhe trajtimi i dytë kur fruti arrin madhësinë e kokrës së arrës; kunder ndryshkut të kumbullës (*Tranzschella pruni-spinosa*) kryhen 1-2 trajtime me sfaqjen e simptomave të para. Doza e përdorimit është 50-75 ml/100 lit ujë

**Në vreshta:** kunder hirit (*Uncinula necator*), duke përsëritur trajtimet cdo 10 ditë, me 40 ml/100lit. ujë, por jo më pak se 400 ml/ha preparat. Në kushtet kur favorizohen infeksione të rrënda mund të kombinohet me sqfur granular 0.2 % për të kombinuar veprimin sistematik me atë të kontaktit.

**Në drithra:** kunder kalbëzimit të qafës (*Pseudocercospora herpotrichoides*, *Ophiobolus graminis*) trajtimi kryhet në fillim të ngritjes; kunder hirit (*Erysiphe graminis*) dhe ndryshkut (*Puccinia spp.*). Trajtimi kryhet me konstatimin e shenjave të para; kunder pirenofores (*Pyrenophora teres*), rinkosporiozës (*Rhynchosporium secalis*) trajtimi kryhet në fazën e ngritje-kallëzimit; kunder fuzariozës së kallirit (*Fusarium spp.*) trajtimi kryhet në fazën e lulëzimit të plotë; kunder septoriozës (*Septoria spp.*) trajtimi kryhet në fazën e ngritje-kallëzimit. Doza e përdorimit 1 lit/ha.

**Në tapete jeshile:** kunder mykozave të qafës dhe rrënjës (*Microdocium nivale*, *Sclerotinia homeocarpa*, dhe *Rhizoctonia solani*), me 1.5-2 lit/ha në 600-800 lit ujë. Trajtimi kryhet me konstatimin e shenjave të para dhe përsëritet cdo 10-20 ditë.

**Në perime:** (pjeper, shalqi, trangull, kungull, domate, specja, bishtajore, etj.) kunder hirit (*Erysiphe cichoracearum*, *Sphaerotheca fuliginea*, *Leveillula taurica*), ndryshkut (*Puccinia spp.*) me konstatimin e shenjave të para trajtohet cdo 7-10 ditë, me 50 ml./100 lit ujë, por jo më pak se 500 ml/ha preparat.

Në të gjitha kulturat, trajtimet fillojnë me sfaqjen e infeksionit dhe përsëriten cdo 2 javë.

**Vërejtje për përdorimin:** Megjithse ka veprim parambrojtës, kurues dhe çrrënjosës, rezultatet më të mira arrihen kur përdoret si parambrojtës ose në statet e para të zhvillimit të sëmundjes.